



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE

RELACION

**MIRATIMIN E SHTRYRJES SË AFATIT TË PAGESËS SË TAKSAVE DHE
TARIFAVE VENDORE, PËR VITIN 2020, NGA SUBJEKTET “BIZNES”**

Të nderuar këshilltar !

Këshilli Bashkiak me Vendimin nr.60 datë 18.12.2019 ka miratuar paketën fiskale në të cilën janë përcaktuar edhe afatet ligjore të pagesës së taksave dhe tarifave për subjektet që ushtojnë aktivitet tregtar në Bashkinë Berat. Duke u nisur nga përhapja e pandemisë të COVID-19 në vendin tonë, si dhe në bazë të vendimeve dhe udhëzimeve të qeverisë me të cilët janë pezulluar aktiviteti tregëtar është krijuar pamundësia e këtyre subjekteve për të paguar brenda afatit detyrimet të përcatuar në VKB nr.60 datë 18.12.2019.

Për sa më sipër propozojmë:

1. Faljen e tarifës përdorimit hapësirës publike në Bashkinë Berat për subjektet për periudhën mars – prill 2020.
2. Shtyrjen e shtryrjes së afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2020, nga subjektet “biznes”, për shkak të periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19, për taksat dhe tarifat vendore, si më poshtë vijon:

I. Taksat vendore,

Pika 2.a Taksa mbi ndërtesat,

-Afatet e pagesës ndërtesës që përdoret për qëllime biznesi

- Kësti i parë, brenda datës 20 Prill



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE

- Kësti i parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti i dytë, brenda datës 20 Qershor

II. Tarifat Vendore

Pika 1. Tarifa e pastrimit e largimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike

Pika 2. Tarifa e ndriçimit publik

Pika 3. Tarifa e gjelbërimit publik

Pika 4. Tarifa për infrastrukturën arsimore

-Afatet e pagesës

- Për kategorinë II “Subjekte të biznesit vogël dhe “subjekte të biznesit madh” detyrimi paguhet me dy këste të barabartë
- Kësti i parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti i dytë, brenda datës 20 Korrik

Pika 5 Tarifa e parkimit të automjeteve

-Afatet e pagesës

- Për kategorinë I “Subjekte të transportit të udhëtarëve” dhe kategorinë II “subjekte që kanë mjet në funksion të aktivitetit tregtar” detyrimi paguhet me një kësht të vetëm
- Brenda datës 20 Prill

Të gjitha këto afate të ndryshojnë,

I. Taksat vendore,

II. Tarifat Vendore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT/VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2020

**MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË PAGESËS SË TAKSAVE DHE
TARIFAVE VENDORE, PËR VITIN 2020, NGA SUBJEKTET "BIZNES"**

Në mbështetje të nenit 35, të gërmës "f" të nenit 54, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, dhe Aktit Normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19", të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I :

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2020, nga subjektet "biznes", për shkak të periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19, përkatësisht: kësti i parë, brenda datës 5 qershor 2020, kësti i dytë, brenda datës 5 Shtator 2020, për taksat dhe tarifat vendore, si më poshtë vijon:

➤ Taksat vendore,

Pika 2.a Taksa mbi ndërtesat,

Pika 2.c Taksa mbi Trullin,

Pika 6 Taksa e tabelës

➤ II.Tarifat Vendore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Pika 5 Tarifa e parkimit të automjeteve

2. Fajten e "tarifës së përdorimit të hapësirës publike në Bashkinë Berat" për subjektet "biznes", për periudhën mars – prill 2020.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Ervin Ceca

